

10 MITE RRETH BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË NË KOSOVË

E vërteta mbi to dhe mësimet e nxjerra nga SEERmap rreth të ardhmes së
sektorit të energjisë elektrike



10 MITE RRETH BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGISË NË KOSOVË

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Tetor, 2018**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Hyrje

10 mite rreth burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë: e vërteta mbi to dhe mësimet e nxjerra nga SEERmap rreth të ardhmes së sektorit të energjisë elektrike është një publikim që realizohet në kuadër të projekteve 'Dialogu i Ballkanit Perëndimor për Tranzicionin e Energjisë - WeBET' si dhe 'South East Europe Energy Transition Dialogue – SE3T'.

Këto projekte koordinohen nga think-tank gjerman Agora-Energiewende (Berlin) dhe partneri implementues për Kosovë është Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP.

Qëllimet kryesore të projektit janë:

- (1) promovimi i rezultateve të projektit 'Udhërrëfytyesi i Evropës Juglindore për sektorin e energjisë elektrike – SEERmap¹;
- (2) propozimet për zhvillimin e politikave për tranzicionin e energjisë në sektorin e energjisë elektrike në Rajonin e Evropës Juglindore;
- (3) mbështetja e vendimmarrësve në Kosovë në përgatitjen e planeve të tranzicionit të energjisë.

Ky punim publikohet në Ditën Botërore të Energjisë, së pari e iniciuar në 2012 nga Forumi Botëror i Energjisë si një ditë për të rritur ndërgjegjësimin për përdorimin e energjisë dhe për të nxitur përpjekjet globale të dekarbonizimit.

Të dhënat e prezantuara në vijim janë një paraqitje e miteve të cilat janë përhapur rreth Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) në Kosovë të pasuara nga fakte dhe të gjetura nga projekti SEERmap, i cili zhvilloi udhërrëfytyes afatgjatë të energjisë elektrike për Europën Juglindore (duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Greqinë). Sipas këtij raporti, vërja në funksion e BRE-ve në Ballkanin Perëndimor është diçka e realizueshëm dhe ka disa përparësi në kraasim me investimet e bazuara në karburantet fosile.

¹RAPORTI I SEERMAP PËR KOSOVËN

I qasshëm tek: https://rekk.hu/downloads/projects/SEERMAP_CR_KOSOVO_A4_ONLINE.pdf

1. Burimet fosile të energjisë janë më të lira se BRE-të

“Prodhimi i energjisë elektrike i bazuar në burime fosile të energjisë është ende opsioni më i lirë”

E vërteta

Bazuar në kornizën aktuale legislative si dhe karakteristikat e tregut, prodhimi i energjisë elektrike me bazë fosile mund të jetë opsioni më i lirë, pasi që shumica e impianteve të energjisë në rajonin e Ballkanit Perendimor janë të vjetra dhe investimi fillestar në impiant është rikuperuar, duke u mundësuar atyre të operojnë me çmime që janë të mjaftueshme për rikuperimin e shpenzimeve afatshkurtra marginale. Megjithatë, hartuesit e politikave në sektorin e energjisë duhet të marrin parasysh faktorët e paraqitur më poshtë:

1. Rritja e parashikuar e çmimit të karbonit në krahasim me nivelet aktuale, do të bëjë impiantet e lëndëve djegëse fosile, veçanërisht qymyrin dhe linjitin më pak konkurrues;
2. Trendet tregojnë se BRE-të po bëhet gjithnjë e më të lira, trend ky që po zhvillohet shumë shpejtë, duke rritur kështu konkurrueshmërinë e këtyre teknologjive karshi prodhimit të energjisë elektrike me bazë fosile;
3. Do të duhet të ndodhë heqja graduale e subvencioneve direkte dhe indirekte ndaj impianteve të lëndëve djegëse fosile, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, ku një mbështetje e tillë është ende prezente. Kjo do të ulë konkurrencën e gjenerimit të bazuar në fosile;
4. Kërkesat e reja BAT (teknologjia më e mirë në disozicion) për impiantet e mëdha të djegies të publikuara në 2017 do të duhet të zbatohen nga viti 2021 e tutje. Kjo do të bëjë investimet në instalimet e reja të thëngjillit dhe pajtueshmërinë me rregullat për instalimet ekzistuese dukshëm më të kushtueshme;
5. Kostoja e eksternaliteteve negative të shkaktuara nga gjenerimi i lëndëve djegëse fosile është i lartë, sidomos shpenzimet mjedisore dhe shëndetësore.


Po ashtu, kostot e jashtme, të tilla si kostoja shëndetësore, duhet të merren në konsideratë kur llogaritet çmimi i prodhimit të energjisë të bazuar në burime fosile. Çdo vit rreth 400 000 njerëz vdesin para kohe në Evropë për shkak të ndotjes së ajrit. Metalet e rënda (p.sh. zhiva) lirohen në ajër nga termocentralet me qymyr. Këto mund të ndikojnë në sistemin imunitar, duke rrezikuar më së shumti jetët e fëmijëve. Vetëm kursimet nga shmangia e dëmeve shëndetësore vlerësohen në mes të 19 miliard dhe 71 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2030, ndërsa kostot mjedisore të evituara me vendosjen e BRE-ve vlerësohen në mes të 8 miliard dhe 37 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2030. Kështu, së bashku me kursimet nga shmangia e shpenzimeve të jashtme të shëndetit dhe mjedisit, vendosja e përshpejtuar BRE-ve do të rezultojë në kursime të përgjithshme prej 52 miliardë dollarë deri në 133 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2030 (IRENA, 2018).

2. BRE-të rrisin çmimin e energjisë elektrike

“Çmimet e energjisë elektrike do të rriten për shkak të BRE-ve. Mbështetja që i ofrohet BRE-ve si dhe përhapja e tyre do të ndikojnë në rritjen e faturave të energjisë elektrike. Sistemet energjetike të bazuara në BRE janë më të shtrenjta. Tranzicioni drejt BRE-ve nuk është financiarisht i përballueshëm.”

E vërteta

Në bazë të skenareve të modeluara nga projekti ‘Udhërrëfyese për sektorin e energjisë elektrike në Evropën Juglindore – SEERmap’², çmimi i energjisë elektrike ndjek pothuajse të njëjtën trajektore në të gjitha skenarët dhe ndryshon vetëm pas vitit 2045, kur çmimet në skenarin me më shumë BRE në mix-in e energjisë elektrike janë më të ulëta si rezultat i koston së ulët margjinale të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të. Rritja mesatare vjetore e çmimeve në Kosovë gjatë gjithë periudhës është 2.9% në 'skenarin pa targete', 2.2% në 'skenarin e vonuar' dhe 2.3% në 'skenarin e dekarbonizimit'. Në skenarin e dekarbonizimit dhe skenarin e vonuar, çmimi i energjisë elektrike ndryshon vetëm pas vitit 2045 kur çmimet janë më të ulëta si rezultat i koston së ulët margjinale të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të



MESATARJA E MBËSHTETJES PËR BRE PËR MËH TË TOTALIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SI DHE MESATARJA E ÇMIMIT ME SHUMICË, 2016-2050 (€/MËh). BURIMI: RAPORTI I SEERMAP PËR KOSOVËN

Mbështetja e nevojshme për të stimuluar investimet në BRE në ‘skenarin e dekarbonizimit’ mbetet e papërfillshme gjatë gjithë periudhës (nën 2 euro/MËh). Në ‘skenarin e vonuar’, nevojitet një vendosje e shpejtë e kapaciteteve shtesë në fund të periudhës së modeluar për të arritur objektivat e dekarbonizimit të 2050-ës, duke rritur mbështetjen mesatarisht në nivel prej 15.4 euro/MËh gjatë dekadës së fundit, ekuivalent me 16% të koston totale të energjisë elektrike. Këto rezultate tregojnë se nuk janë BRE-të në vetvete të cilat janë të shtrenjta, por se veprimi i vonuar dhe i paplanifikuar për BRE do të rritë ndjeshëm koston. Një panel i ekspertëve të jashtëm të Bankës Botërore vlerësoi LCOE të një centrali të ri të qymyrit në Kosovë në përafërsisht 81.42 €/MËh, i cili do të jetë jo konkurrues me gjenerimin nga BRE-të kur të përfundojë ndërtimi i tij. Nëse ia shtojmë kësaj edhe çmimet gjithnjë në rritje për CO2 të cilat rrisin koston e prodhimit të qymyrit, delse një një impiant i ri qymyri është rruga më e shtrenjtë për të plotësuar kërkesën e ardhshme të energjisë elektrike në Kosovë.

² RAPORTI I SEERMAP PËR KOSOVËN


I qasshëm tek: https://rekk.hu/downloads/projects/SEERMAP_CR_KOSOVO_A4_ONLINE.pdf

3. Potenciali i BRE-ve është i pamjaftueshëm për të mbuluar kërkesën

"Planet për zhvillimin e BRE-ve nuk janë reale. BRE-të mund t'i përgjigjen pjesërisht nevojave tona. BRE-të vetëm nuk mund të përmbushin kërkesat e tregut. Ne nuk kemi potencial të mjaftueshëm të BRE-ve, veçanërisht sa i përket erës. "

E vërteta

Pavarësisht nëse Kosova ndjek një politikë aktive për të dekarbonizuar sektorin e saj të energjisë elektrike, kapacitetet e bazuara në BRE do të zgjerohen ndjeshëm nga nivelet aktuale të ulëta. Bazuar në rezultatet e SEERmap, Kosova do të arrijë një pjesëmarrje prej 44% të BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike deri në vitin 2050, edhe nëse nuk cakton target për reduktim të emetimeve; pjesëmarrja e BRE-ve madje arrin 85% në 'skenarin e vonuar'. Depërtimi i lartë i BRE-ve në të gjitha skenarët sugjeron që politikat energjetike në Kosovë duhet të përqendrohen në mundësimin e integritit të BRE-ve. Rezultatet optimale mund të arrihen vetëm kur përdoret një mix i burimeve të ripërtëritshme të energjisë përfshirë atë diellore, hidrike dhe energjisë nga era.



GJENERIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE DHE KËRKESA (TËh) DHE PJESËMARRJA E BRE-VE (% E KËRKESËS) NË KOSOVË, 2020-2050. BURIMI: RAPORTI I SEERMAP PËR KOSOVËN

Shfrytëzimi i potencialit teknik të BRE-ve deri në vitin 2050 është më i larti në 'skenarin e vonuar'. Respektivisht, 80% hidro, 91% erë dhe 71% energji me diell. Në skenarin 'dekarbonizimit', shfrytëzimi i potencialit të erës është dukshëm më i ulët - 72%.

Studime të tjera po ashtu zbulojnë se ekzistojnë një varg alternativash për të plotësuar kufizimet aktuale të furnizimit, të gjitha me një kosto më të ulët sesa ndërtimi i një impianti të propozuar prej 450 M€ neto. Opsionet përfshijnë masat e efijencës së energjisë, kombinimet e energjisë nga dielli, era, uji, biomasa dhe futja e gazit natyror.

4. BRE-të nuk mbulojnë sigurinë e furnizimit

Burimet e Ripërtrishme të Energji nuk japin energji stabile sipas kërkesës. Ato nuk janë fleksibile dhe janë të paparashikueshme. Siguria e furnizimit me energji nuk mund të mbahet nëse më shumë burime të ripërtëritshme shtohen në rrjet. Nivelet e penetrimit të BRE-ve duhet të kufizohen për arsye të sigurisë energjetike. Sistemet me bazë në BRE janë të paqëndrueshme dhe jo fleksibile për shkak të ndërprerjes së njërive të prodhimit. Niveli i lartë i penetrimit të burimeve të ripërtëritshme mund të ndikojë negativisht në sigurinë e furnizimit. Një pjesëmarrje e lartë e BRE-ve në rrjet do të çonte në dështimin e sistemit. Një sistem energjetik i bazuar në sistemet e energjisë së ripërtrishme kërcënon sigurinë e energjisë. Burimet e Ripërtrishme nuk mund të garantojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike. BRE-të si burime janë të kohë-pas-kohshme në natyrë dhe për këtë arsye nuk ka garanci se një pjesë e madhe e kërkesës për energji elektrike mund të mbulohet. Shpërndarja më e lartë se 30% e BRE-ve (me përjashtim të potencialeve ujore) nuk është teknikisht e realizueshme. Sistemet me bazë në BRE sigurojnë energji elektrike që është me cilësi më të ulët!”

E vërteta

Për Kosovën, adekuacia e gjenerimit rezulton negative në projektimin e vitit 2025 por adekuacia e sistemit sipas llogaritjes së SEERMAP është positive në të gjitha orët e të gjitha viteve. Në disa orë të vitit Kosova duhet të mbështetet në import për të plotësuar kërkesën e saj. Në anën tjetër, nëse varem vetëm në kapacitetin kombëtar kjo ka një kosto shtesë të kapacitetit të rezervës prej 40 milion EUR në vit mesatarisht midis viteve 2025-2050, duke arritur në 60-70 milion EUR në vit nga viti 2040. Edhe pse kjo tregon se është e mundshme që e tërë energjia elektrike të bazohet në kapacitetet vendore, jmimi është jashtëzakonisht i lartë. Ndërlidshmëria e rrjetit është më e rëndësishme dhe me kosto optimale për Kosovën.

Siguria e furnizimit do të thotë jo vetëm “Sa kapacitete kemi?” por edhe “Çfarë lloj kapacitetesh?”. Sistemi energjetik i së ardhmes kërkon një përzirje të burimeve fleksibile dhe siguria e furnizimit duhet të vlerësohet përtej kufinjëve.³

Se Qeveria e Kosovës ka prioritet sigurinë e furnizimit është vetëm një mit. Për së paku dhjetë vite rresht, Bashkimi Evropian tërheqë vëmendjen se Kosova nuk ka rezervë të naftës për më shumë se 4 ditë ndërkohë që legjislacioni evropian kërkon të kemi sasi reserve e barasvlefshme me 90 ditë të importit. Ligji për Rezervat e Obligueshme të Naftës nuk silltet në Kuvend dhe nafta nuk trajtohet fare në Strategjinë e Energjisë 2018-2026! Pra, siguria e furnizimit, e njërit prej produkteve kryesore energjetike është zero!

³ AGORA, (2014), *Principet e tregjeve të energjisë dhe siguria e furnizimit*, i qashtëm në <https://www.agora-energiewende.de/en/press/news-archive/principles-for-power-markets-and-security-of-supply/> (qasur në tetor, 2018).

5. BRE-të kërkojnë investime të shtrenjta në rrjet

“Zgjerimi i BRE-ve çon në rritjen e kostove të rrjetit. Burimet e ripërtrishme kanë nevojë për përmirësime të shtrenjta të rrjetit. Përmirësimi i infrastrukturës së vjetër konsiderohet shumë i kushtueshëm dhe vështirë se mund të përballohet në afat të shkurtër.”

E vërteta

Sistemi i transmisionit i Kosovës është i lidhur mjaft mirë me vendet fqinje, por nevojiten investime shtesë të rrjetit në linjat e brendshme të transmisionit të tensionit të lartë dhe në nivelin e shpërndarjes. Rrjetit do t'i duhej të përballonte rritjen e integritetit të BRE-ve dhe tregtinë ndërkufitare të energjisë. Ngarkesa e pikut pritet gjithashtu të rritet nga 1182 MË në vitin 2016 (Sipas Databazës së ENTSO-E-së) në 1630 MË në vitin 2030 (Sipas Databazës së SECI) dhe në 2310 MË në vitin 2050.

Analiza e kontigjencës së kufizimeve të rrjetit sugjeron kontigjenca që mund të zgjidheshin me investime prej 72.5 milion Euro deri në vitin 2050 (krahas rekomandimeve të ENTSO-E TYNDP 2016)

	Overloading	Solution	Units (km or pcs)	Cost m€
2030	WPP Bela Anta – WPP Košava, or OHLs 110 kV WPP Bela Anta – WPP Alibunar	Reconstruction of the OHL from 150 mm ² to 240/40 mm ²	65	6.5
2050	n.a.	SS Skakavica (AL) + 400 kV OHLs (to Tirana (AL) and Prizren (KS))	130 + SS 400 kV	65

FIGURA 1 – Mbingarkesa në sistemin e rrjetit të Kosovës*, 2030 dhe 2050. Burimi: Raporti i SEERMAP për Kosovën

Sipas analizës së rrjetit, humbjet në rrjetin e transmisionit afektojnë në mënyra të ndryshme. Nga njëra anë, humbjet reduktohen pasi që burimet e ripërtëritshme, sidomos PV, lidhen kryesisht me rrjetin e shpërndarjes dhe si rezultat distanca midis prodhimit dhe konsumit zvogëlohet. Nga ana tjetër, nivelet e larta të tregtisë së energjisë elektrike deri në vitin 2050 në sezonin veror do të rrisin humbjet e rrjetit të transmisionit.

Në përgjithësi, disa investime në rrjetin e transmisionit janë të nevojshme për të akomoduar kapacitetet e reja të BRE-ve në sistemin e energjisë elektrike të Kosovës, por kostoja e vlerësuar e investimeve të rrjetit mbetet nën 173 milion për periudhën deri në vitin 2050, krahas investimeve të përfshira në ENTSO-E TYNDP (Entso- e, 2016). Kjo shifër përfshin jo vetëm kostot e rrjetit të transmisionit, por edhe kostot e nevojshme për lidhjen e objekteve, si dhe përforcimin e rrjetit kombëtar për të lehtësuar rritjen e pritshme të gjenerimit nga BRE-të. Megjithatë, këtu nuk përfshihen nevojat për investime në rrjetin e shpërndarjes, të cilat mund të jenë të konsiderueshme për shkak të rritjes së kapacitetit gjenerues solar në veçanti.

6. Mbulimi i kërkesës minimale është i nevojshëm për sigurinë e sistemit

“Me penetrim të madh të BRE-ve, rrezikohet stabiliteti i sistemit elektroenergjetik. Stacionet energjitike të ngarkesës bazë (baseload) janë të nevojshme për të përmbushur kërkesën bazë. Instalimi i shumë BRE-ve bazohet në fuqinë e importuar nga linjat e transmetimit nga stacionet e energjisë me baseload në vende të tjera. Siguria e furnizimit mund të arrihet vetëm nga burimet e energjisë së qymyrit (fosile). Prodhimi i energjisë elektrike me qymyr (lëndë djegëse fosile) është thelbësor për stabilitetin e sistemit. Përdorimi i termocentraleve me kogjenerim është zgjidhja e përkohshme kalimtare. Heqja e thëngjillit dhe zëvendësimi me BRE është e pakuptimtë dhe akoma më e paqëndrueshme, pasi vazhdimi i mëtejshëm i mbështetjes ndaj qymyrit do të mundësojë vetë-mjaftueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit dhe pavarësinë energjetike. Prodhimi i energjisë elektrike me qymyr / lëndë djegëse fosile është thelbësor për stabilitetin e sistemit.”


E vërteta

Për shkak të nivelit të lartë të lidhjes me fqinjët e saj, adekuacia e sistemit mbetet pozitive deri në periudhën e transformimit të plotë të sistemit energjetik më 2050, megjithëse kapaciteti i instaluar i prodhimit brenda vendit nuk i mundëson Kosovës të kënaqë kërkesën e brendshme duke përdorur gjenerimin e brendshëm në të gjitha orët e vitit për të gjitha vitet.

Unit name	Installed capacity [MW]	Expected year of commissioning	Expected year of decommissioning	Fuel type	Type	CCS	No target	Delay	De-carbon
Kosovo A1	65	1962	2023	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosovo A2	125	1965	2023	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosovo A3	200	1970	2023	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosovo A4	200	1971	2023	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosovo A5	210	1975	2023	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosovo B1	339	1983	2040	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosovo B2	339	1984	2040	lignite	thermal	no	yes	yes	yes
Kosova e Re Power	500	2023	2063	lignite	thermal	no	yes	yes	no
Kosovo GAS TPP	200	2035	2065	natural gas	thermal	no	yes	yes	no
NEW TPP	600	2041	2081	lignite	thermal	yes	yes	yes	no

Lista e njësive të gjenerimit të përfshira në modelin e skenarëve në Kosovë. Burimi: Raporti i SEERMAP për Kosovë

Termocentrali Kosova e Re, e bazuar në linjit me 450 MË, që është planifikuar të ndërtohet sipas strategjisë aktuale energjetike kombëtare, është faktorë kryesor i rrezikut lidhur me kostot e bllokua të aseteve.



Sidoqoftë, pra, pa këto dy termocentrale, vetëm me një termocentral me fuqi 200 MË, është e mundur të ruhet stabiliteti i furnizimit me 76.4% të BRE-ve në skenarin e dekarbonizimit deri në vitin 2050.

7. BRE-të janë të imponuara nga ana e BE-së

"BE-ja dikton objektivat të cilat duhet të respektohen pa kushte nga vendet të cilat synojnë anetarësimin. Vendosja e BRE-ve e parë nga perspektiva e nivelit të politikave është perceptuar më shumë si një çështje e një detyrimi që rrjedh nga perspektiva e BE-së dhe procesi i integritit".

E vërteta

Kosova ka një potencial të favorshëm për BRE-të, të cilat potencialisht mund të sigurojnë 85% të konsumit të energjisë elektrike deri në vitin 2050. Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë do të jetë zgjidhja më e lirë e mundshme gjatë një periudhe afatgjatë, përderisa çmimi i karburanteve fosile dhe emitimeve të CO₂ rritet, ndërsa kostoja e teknologjive të BRE-ve bie.

Nëse përcatkohemi për një strategji të bazuar në burimet e ripërtëritshme të energjisë, veprimi i planifikuar afatgjatë ofron avantazhe të qarta:

1. Kostot e asetëve të zhvlerësuara para kohës janë dukshëm më e lartë në 'skenarin e vonuar', krahasuar me skenarin e dekarbonizimit (8.1 EUR/MËh kundrejt 0.1 EUR/MËh).
2. Mbështetja e nevojshme për nxitjen e burimeve të ripërtëritshme është konsiderueshëm më e lartë në 'skenarin e vonuar'. Vlerësohet që niveli i mbështetjes do të arrijë 15.4 euro/MËh (16% të kostos totale të gjenerimit të energjisë elektrike) gjatë dhjetë viteve të fundit. Kjo për shkak se në fund të periudhës së modeluar nevojitet vendosja e shpejtë e kapaciteteve shtesë.
3. Çmimi i energjisë elektrike është më i ulët gjatë një periudhe afatgjatë në një sistem me një përqindje të lartë të BRE-ve si rezultat i kostos së ulët marginale të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE.

8. BRE-të nuk janë të qëndrueshme

"BRE-të (veçanërisht era) përbëjnë një kërcënim për ekosistemet (p.sh. zogjtë). BRE-të janë po aq të dëmshme për mjedisin si energjia konvencionale. "

E vërteta

Planifikimi dhe analiza që lidhen me vendosjen, teknologjinë dhe funksionimin e turbinave të erës janë të nevojshme për të shmangur pasojat negative ekologjike. Ekzistojnë hulumtime të cilat fokusohen në efektin e llojeve të ndryshme të turbinave me erë në vende të ndryshme gjeografike dhe ka rekomandime se si mund të shmangët dëmtimi ekologjik duke zgjedhur llojin e duhur të turbinës me erë dhe vendndodhjen e duhur. Prandaj, studimet e hollësishme lokale duhet të realizohen për të eksploruar zonat e mundshme të konfliktit dhe për t'i përjashtuar ato nga lista e vendeve të vëna në dispozicion të investitorëve të erës. Në këtë mënyrë, pasojat mjedisore të termocentraleve të erës mund të reduktohen në një nivel minimal. Përveç kësaj, opsionet e ndryshme operative mund të zvogëlojnë ndikimet negative ekologjike. Për shembull, kufizimi i rrotullimit të tehut me shpejtësi të ulët të erës si dhe mbyllja selektive e turbinave rezultojnë në reduktime të konsiderueshme (50-87%) në fatalitetin e zogjëve. Sistemet e monitorimit dhe kontrollit të zogjve, duke përfshirë veprimet automatike në kohë reale, si paralajmërimi dhe zbrapsja e zogjve nëse ekziston rreziku i përplasjes, janë gjithashtu zgjidhje efektive për reduktimin e kërcënimeve ndaj zogjve.

Rasti i hidroenergjisë është më i komplikuar nga aspektet e qëndrueshmërisë. Në përgjithësi, ekosistemet e ujërave dhe burimeve natyrore janë dukshëm të rrezikuara. Në afërsi të impianeteve që prodhojnë energji nga uji, ndodhin fenomene të tilla siç është përmytja e habitateve, zhvendosja e komuniteteve njerëzore, si dhe modifikimi i regjimit të ujit në rrjedhën e shkaktuar nga digat dhe infrastruktura. Kur rrjedhat natyrore ndryshohen dukshëm, popullatat e specieve të ujërave dhe burimeve natyrore reduktohen ose zhduken tërësisht. Për këto çështje nevojitet planifikimi i integruar i basenit, i cili integron hidrocentralin me operacionet e kontrollit të përmytjeve dhe menaxhimin e sipërfaqeve të përmytjeve.

9. BRE-të ndikojnë në humbje të vendeve të punës

"Tranzicioni nga thëngjilli shkakton humbje të vendeve të punës që nuk mund të kompensohen. BRE-të nuk mund të kompenzojnë vendet e punës që lidhen me operimin e termocentraleve të bazuara në format konvencionale të energjisë si dhe aktivitetet e ndërlidhura me to (p.sh. punëtorët që punojnë në minierat e linjtit)."

E vërteta

Pavarësisht trendeve negative në industrinë e qymyrit, BRE-të paraqesin mundësi të reja për zhvillimin ekonomik si dhe bashkëpunimin rajonal.

Rritja e sektorit të energjisë së BRE-ve mund të sigurojë një zgjidhje ideale për krijimin e vendeve të punës në vendet që i nënshtrohen tranzicionit nga qymyri si dhe në sektorin e energjisë në përgjithësi. Studimet kanë treguar se teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme janë më intensive se ato të teknologjive të karburanteve fosile, ku teknologjitë PV ofrojnë numrin më të lartë të viteve të punës për GËh gjatë jetës së impiantit. Studimet tregojnë gjithashtu se ekziston një potencial i konsiderueshëm i ardhshëm për krijimin e vendeve të punës në BRE dhe që mund të shoqërohet me krijimin neto të vendeve të punës.

Sipas IRENA, punët në sektorin e energjisë diellore tani tejkalojnë vendet e punës në minierat e qymyrit, në industrinë e naftës si dhe atë të gazit së bashku. Për më tepër, sektori i energjisë së ripërtëritshme punëson më shumë gra sesa sektori i naftës, gazit dhe qymyrit (IRENA, 2017a). Sot, sektori i BRE-ve punëson rreth 1.2 milionë njerëz në Evropë, shifër kjo e cila do të rritet ndjeshëm duke përbushur objektivat e BE deri në vitin 2030 (IRENA, 2018).

Raportet e fundit në vendet e OECD vijnë në të njëjtin përfundim: sektori i BRE-ve dhe eficientia e energjisë krijojnë më shumë vende pune sesa industria fosile.

10.BRE-të rrezikojnë vetë-mjaftueshmërinë

"Ne duhet të mbetemi eksportues të energjisë elektrike ose do të humbim profitë të mëdha. Varësia e importit duhet të shmanget - ne duhet të jemi të vetë-mjaftueshëm. Bashkimi ndërkufitar do të promovojë importin e energjisë elektrike me kosto të ulët nga vendet e tjera, duke penalizuar kështu prodhimin lokal të energjisë elektrike dhe veçanërisht BRE-të. "

E vërteta

Një treg konkurrues i energjisë elektrike, nëse nuk kufizohet nga kapaciteti ndërkufitar i rrjetit, do të rezultojë në nivele të tregtisë që sigurojnë një alokim optimal të prodhimit në të gjithë vendet. Eksportimi i energjisë elektrike është i dobishëm për një vend, vetëm nëse energjia elektrike mund të prodhohet me kosto më të ulët në atë vend se sa në vendet fqinje.

Në këtë rast, prodhuesit e energjisë elektrike mund të përfitojnë duke prodhuar energji elektrike dhe duke e eksportuar atë në vende të tjera. Nëse nuk është kështu, dhe importet e energjisë elektrike janë më të lira se prodhimi vendas, atëherë importimi i energjisë elektrike është zgjidhja optimale shoqërore, pasi siguron një çmim më të ulët të energjisë elektrike që është i dobishëm për konsumatorët. Krahas të njëjtës logjikë, synimi për vetë-mjaftueshmëri të plotë në prodhimin e energjisë elektrike mund të vijë me një kosto të konsiderueshme në krahasim me një situatë kur vendi është në gjendje të mbështetet në importe më të lira.



Rr. Fehmi Agani, nr. 50, A/4,
Prishtinë, Republika e Kosovës
www.indep.info
office@indep.info